



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 754	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 21	
Data / Datum / Date: 01/04/2019 Pejë / Peć		

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Senati

Ref. Nr.

Pejë, me 01.04.2019

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 48, nenin 167, nenin 169 dhe nenin 170, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Nr. 04-V-622, 2013, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, dt. 19.10.2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, dhe Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin - (aneksi - I - MASHT) 7/2018 e UA Nr.01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, me datë 01.04.2019, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

**PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN, RIEMËRIMIN
DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK TË RREGULLT NË
UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave vlerësuese dhe procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt, të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë (në tekstin e mëtejme: "UHZ"), duke përfshirë profesorët e rregullt, profesorët e asocuar, profesorët asistentë, asistentët, lektorët, kooperatorët dhe kategoritë e tjera të parapara me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Çështjet që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e UHZ-së lidhur me procedurën e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik, rregullohen me dispozitat vijuese të kësaj Rregullore.

**Neni 2
Fushëveprimi**

S. Mucic

1. Kjo Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në UHZ, vlen vetëm për personelin akademik të rregullt.

2. Ndërsa për personelin akademik të angazhuar duhet bazuar në “Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë”.

Neni 3

Personeli akademik

Në pajtim me nenin 167, paragrafi 2, të Statutit, personeli akademik i Universitetit përbëhet nga : Profesorë të Rregullt; Profesorë të Asocuar; Profesorë Asistentë; Asistentë Universiteti; Lektorë dhe Koorepetitorë (Fakulteti i Arteve).

Neni 4

Kriteret për emërimin në thirrje akademike

1.Procedura vlerësuese për zgjedhje në thirrje akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:

- (1) Aktiviteti arsimor (A) - Shtojca I
- (2) Aktiviteti hulumtues dhe shkencor (H) - Shtojca II
- (3) Aktiviteti shërbyes (mbështetja administrative dhe zhvillimi profesional) (SH) - Shtojca III
- (4) Aktiviteti Artistik - Shtojca IV

2. Shtojca I, II , III , IV, format për vlerësimin e kandidatëve sipas sistemit në bazë të pikëve, si dhe forma e aplikacionit për kandidatët janë pjesë përbërëse dhe detyruese e tekstit të Rregullores.

Neni 5

Emërimi në thirrjen e Profesorit të rregullt

1. Në pajtim me nenin 171 të Statutit të UHZ-së, për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

1.1.Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);

1.2.Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:

1.2.1. Një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;

1.2.2. Pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;

- 1.2.3. Krijime ose punime të njohura artistike, ose të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakulteteve të Arteve, në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe artit;
 - 1.2.4. Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
 - 1.2.5. Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
 - 1.2.6. Aftësi për udhëheqje akademike;
 - 1.2.7. Udhëheqje të termave master dhe të doktoratës.
2. Numri i botimeve të kërkuara në këtë dispozitë llogaritet nga koha e zgjedhjes në thirrjet e fundit. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies.

Neni 6

Emërimi në thirrjen e Profesorit të Asocuar

1. Në pajtim me nenin 172, të Statutit të UHZ-së, për titullin e Profesorit të Asocuar, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
 - 1.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;
 - 1.3. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve;
 - 1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.5. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse.
2. Numri i botimeve të kërkuara në këtë dispozitë llogaritet nga koha e zgjedhjes në thirrjen e fundit. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies.

Neni 7

Emërimi në thirrjen e Profesorit Asistent

1. Në pajtim me nenin 173, të Statutit të UHZ-së, për titullin e Profesorit Asistent, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
 - 1.2. Të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve, të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku një (1) punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;

- 1.3. Të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;
 - 1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.5. Të ketë së paku tre vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet;
 - 1.6. Kandidati i cili zgjidhet për herë të parë, nuk duhet të jetë më i vjetër se 55 vjeç.¹
2. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies.

Neni 8

Emërimi në thirrjen e Asistentit të Universitetit

1. Në pajtim me nenin 174, të Statutit të UHZ-së, për titullin e Asistentit të Universitetit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduara me sukses studimet Master në drejtimin përkatës;
 - 1.2. Të jetë jo më i vjetër se 28 vjeç², kur emërohet për herë të parë;
 - 1.3. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet, me rastin e rizgjedhjes;
 - 1.4. Të ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo më pak se tetë (8), në secilën prej këtyre studimeve.

Neni 9

Emërimi në thirrjen e Lektorit dhe Koorepetitorit

1. Në pajtim me nenin 175, të Statutit të UHZ-së, për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduara me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
 - 1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se tetë (8), në secilën prej këtyre studimeve.
2. Për titullin e Koorepetitorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 2.1.1.** Të ketë të përfunduara me sukses studimet Master, drejtimi i pianos ose ndonjë instrument tjetër.
 - 2.1.2.** Të ketë notë mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se tetë (8), në secilën prej këtyre studimeve.

¹ "Jo më i vjetër se 55 vjeç" konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati mbush 56 vjeç.

² "Jo më i vjetër se 28 vjeç" konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati mbush 29 vjeç.

Neni 10
Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Afatet kohore për të cilat bëhet zgjedhja përcaktohen në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në Statutin e UHZ-së.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitat.
3. Thirrja e parë që fitohet në UHZ për kategoritë e mësimdhënësive është Prof. Asistent, ndërsa gjatë procesit të avancimit nuk lejohet kapërcimi i thirrjeve të parapara me Statutin e UHZ-së.
4. Kriteri i moshës së përcaktuar si në nenin 174 të Statutit vlen për kandidatët të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e përmbylljes së konkursit.
5. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në UHZ në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 174 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
6. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
7. Në UHZ nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda të njëjtës njësie akademike, nëse brenda asaj njësie akademike të njëjtit kanë një marrëdhënie të rregullt pune (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
8. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

Neni 11
Procedurat e konkursit për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik

1. Procedura përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën.
2. Konkursi për emërim, riemërim dhe avancim shpallet nga Universiteti – Rektorati, me propozim të njësive akademike, varësisht prej nevojave të njësive akademike dhe

numrit të mjaftueshëm të orëve që duhet të ketë për tu zgjedhur ndonjë mësimdhënës apo asistent.

3. Fakultetet mund të kërkojnë shpalljen në konkurs të pozitive të cilat lidhen me personelin e rregullt të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension.
4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikoj në konkurs meqë të njëjtë, me vendim të Rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
5. Personelit të zgjedhur për pozitat sipas paragrafit 3 të këtij neni, i lëshohet kontrata e punës valide pas pensionimit të personelit përkatës të rregullt në ato pozita.
6. Fakultetet, propozimet e tyre duhet ti bazojnë në nevojat reale, numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve që duhet të ketë një vend pune, për tu zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, asistentit, lektorit apo koorepetitorit.
7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse Fakulteti ofron dëshmi që për atë pozitë ekziston fond i orëve:
 - 7.1. Për pozitë të mësimdhënësit së paku 50% e orëve të parapara për normë të plotë të jenë ligjërata nga lëndët obligative kurse pjesa tjetër e orëve ligjërata nga lëndët zgjedhore;
 - 7.2. Për pozitë të asistentit së paku 50% e orëve të parapara për normë të plotë të jenë ushtrime nga lëndët obligative kurse pjesa tjetër e orëve ushtrime nga lëndët zgjedhore.
8. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozoj Senatit shpalljen e konkursit për vend në staf akademik, edhe nëse ai vend nuk është paraparë me propozimin e njësisë akademike.
9. Konkursi duhet të përmbajë referencën të nenet përkatëse për zgjedhje në thirrje akademike të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" edhe në këtë Rregullore.
10. Konkursi shpallet në ueb-faqen e UHZ-së dhe media të shkruara. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
11. Punëdhënësi në sektorin publik, është i detyruar që një kopje të shpalljes së konkursit publik ta dërgojë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (MPMS)
12. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.

13. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Rektorat, në Zyrën e Protokollit, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të Universitetit të Pejës (apliko.online@unhz.eu).
14. Dokumentet e nevojshme për aplikim për pozita parashihen në konkurs.
15. Pas mbylljes së konkursit, zyra e protokollit harton një raport me shkrim në të cilin përfshihen të dhënat për kandidatët të cilët kanë aplikuar, pozitat për të cilat kanë aplikuar, dhe këtë raport e dorëzojnë në Rektoratin e Universitetit (Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore)

Neni 12

Komisionet vlerësuese

1. Fakulteti është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në Konkurs të caktojë komisionin vlerësues.
2. Më së largu tri (3) ditë pas mbylljes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit në të cilën merret vendimi për themelimin e komisioneve vlerësuese dhe komisionit të ankesave për konkurs në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Komisionet vlerësuese janë organe me besueshmëri të lartë profesionale, akademike dhe etike, të cilat përbëhen prej tre (3) anëtarëve.
4. Komisioni vlerësues propozohet nga radhët e profesorëve në nivel të departamentit/degës ose programit dhe aprovohet në këshillin e fakultetit.
5. Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me pozitën për të cilën është shpallur konkursi.
6. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit “Haxhi Zeka”, këtë Rregullore dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën duhet të shkruhet vlerësimi.
8. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në paragrafin 4, 5 dhe 6 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga departamente të tjera të UHZ-së dhe departamente të universiteteve brenda dhe jashtë vendit.
9. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 4,5,6 dhe 7, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar që kanë

thirrjet e nevojshme akademike nga lëmi përkatës dhe të cilët nuk e kanë kaluar moshën 70 vjeçare, përjashtimisht profesorëve emeritus të cilët kanë kontratë për mbajtjen e mësimit dhe mbi këtë moshë.

10. Dekanët e njësive akademike duhet t'ia ofrojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues dhe po ashtu, me kërkesë të komisionit vlerësues duhet të krijojnë kushte infrastrukturore dhe logjistike për punën më të lehtë të komisionit.
11. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që të thërras anëtarët e tjerë të komisionit dhe të hartojnë raportin e vlerësimit.
12. Komisioni vlerësues është i obliguar që në afat prej njëzet (20) ditëve nga dita e emërimit të dorëzoj raportin e vlerësimit për kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar.
13. Këshilli i Fakultetit përkatës ka të drejtë të ndryshojë përbërje e komisionit vlerësues përkatësisht të formoj komisionin e ri nëse konstatohet se komisioni i parë nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë rregullore. Ky ndryshim duhet të ndodh menjëherë apo një ditë pas afatit të caktuar si në pikën 12 të këtij neni.
14. Pas ndryshimit të përbërjes së komisionit vlerësues, Këshilli i Fakultetit i jep afat komisionit edhe pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.
15. Komisioni vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve të cilët kanë kritere dhe kualitete më të larta në krahasim me kandidatët e tjerë, dhe të arsyetojë rekomandimin e bërë.
16. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin dhe avancimin e kandidatëve të kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët të cilët nuk janë emëruar, riemëruar apo avancuar.
17. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga tre (3) anëtarët, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin e Fakultetit përkatës. Në raste të veçanta pranohet nënshkrimi elektronik, mirëpo Zyra për çështje akademike rezervon të drejtën të konfirmoj nënshkrimin elektronik me anëtarin përkatës të komisionit.
18. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë, sipas kodit të etikës dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi.



Neni 13

Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni Vlerësues

1. Këshilli i Fakultetit, pas pranimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës (jo më vonë se 5 ditë) të shqyrtojë raportin dhe të konstatojë kryerje e punëve në lidhje me raportin e komisionit vlerësues.
2. Këshilli i Fakultetit përkatës, pas mbajtjes së mbledhjes dhe konstatimit të gjendjes së raporteve vlerësuese, brenda dy (2) ditëve i përcjell raportet vlerësuese në versionin elektronik dhe kopjet fizike pranë Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore të UHZ-së.
3. Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore i UHZ-së është i obliguar që brenda shtatë (7) ditëve të punës pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e Këshillave të Fakulteteve, të hartojë buletinet dhe të njëjtit t'i publikoj në ueb faqen e UHZ-së.
4. Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore, përkatësisht personeli i autorizuar, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga Këshilli i Fakultetit përkatës nuk është në rregull me dokumentacionin, atëherë duhet të kërkojë nga Prorektori për mësim që ta obligoj fakultetin përkatës që të kompletoj dokumentacionin para se të dalë në Buletin.
5. Buletinet duhet të qëndrojnë të publikuara në ueb faqe të UHZ-së në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga dita e parë e publikimit.
6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në Buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në Këshillin e Fakultetit përkatës.
7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në organet kompetente të Fakultetit përkatës.
8. Këshilli i Fakultetit përkatës është i obliguar që pas kalimit të afatit të Buletinit, në afat më së largu prej dhjetë (10) ditëve, të vlerësoj raportet e komisioneve vlerësuese dhe të vendosë për miratimin ose jo të atyre raporteve.
9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Këshilli i Fakultetit përkatës është i obliguar që të shqyrtojë edhe ankesat e kandidatëve të cilët kanë parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, (gjatë kohës që Buletinët janë të publikuar) dhe ndaj ankesave të jap përgjigje me shkrim.
10. Këshilli i Fakultetit përkatës është i obliguar që pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth



shqyrtimit të ankesave t'i dorëzojë brenda tre (3) ditëve pranë Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore të UHZ-së.

11. Zyra për çështje akademike ose zyrtari i autorizuar, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga Fakultetet përkatëse, është e obliguar që ta informojë Prorektorin për Mësim, dhe Prorektori për Mësim të kërkojë nga dekanati i Fakultetit përkatës që të kompletojë lëndët.

Neni 14

Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit të Fakultetit dhe Komisionit të studimeve në Senat

1. Në një afat prej njëzetë e pesë (25) ditësh pas pranimit të propozimeve të Këshillit të Fakultetit, Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore përgatitë për Senat pasqyrat me propozimet përkatëse: propozimin e Komisionit Vlerësues, Këshillit të Fakultetit dhe Komisionit të Studimeve në nivel të Rektoratit.
2. Komisioni i studimeve në nivel të Rektoratit shërben si organ këshillëdhënës për Senatin.
3. Propozimet e këshillave të njëjësive akademike për emërimin, ri-emërimin ose avancimin e anëtarëve të personelit akademik shqyrtohen fillimisht nga Komisioni i studimeve, i cili i rekomandon Senatin pranimin ose refuzimin e propozimit.
4. Vendimi i Senatit lidhur me propozimet e cekura në pikën 1 të këtij neni, merret më së largu njëzet (20) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore.
5. Nëse Senati vendos ta refuzojë propozimin e Këshillit të Fakultetit, lënda përkatëse brenda dy (2) ditëve kthehet për rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit.
6. Këshilli i Fakultetit obligohet që brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit të Senatit të rishqyrtoj lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzoj brenda tri (3) ditëve pranë Departamentit për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore të UHZ-së.
7. Nëse Këshilli i Fakultetit, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati në një afat jo më të gjatë se njëzet (20) ditë nga pranimi i tyre, merr vendimin përfundimtar.
8. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet, dhe maksimumi është 30 ditë.

Neni 15



Vendimi, periudha e ankimimit dhe kohëzgjatja e konkursit

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit të Fakultetit lidhur me emërimin dhe avancimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas Rregullore së Punës të Senatit.
2. Në rast se anëtari i personelit akademik nuk i fiton votat e nevojshme për avancim, atëherë Senati mund të votojë për mbetjen në thirrjen ekzistuese.
3. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UHZ.
4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të stafit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UHZ-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet “Rregullorja për procedurën vlerësuese për zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, me Nr.772 të datës 16.06.2014.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati.



Prof. dr. Fadil Millaku
Kryesuesi i Senatit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë

FORMULARËT PËR AKTIVITETET E KANDIDATIT

Shtojca I

FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIEN)

Tabela I.1. Aktivitetet mësimore, me përqendrim të përvojave relevante

(1 vit baras-vlerësohet me 0,10 pikë)

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studenteve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies (p.sh., ligjërata, mësim në ekip, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)	Pikët

Tabela I.2. Cilësia e nxënies dhe mësimdhënies

(Duhet të llogaritet mesatarja për 3 apo 4 vite)

Aktiviteti	Vlerësimi i aktivitetit
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët (<i>pozitiv / negativ</i>)	
Zhvillimi i lëndëve / kurikulave të reja	

Tabela I.3. Mentorimi

Emri i kandidatit	Diploma/ Niveli i studimit	Data e regjistrimit/ të lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit

Tabela I.4. Shpërblime për mësimdhënie

(aktivitet shtesë nuk vlerësohen me pikë, përfshihen edhe aktivitetet shtesë me studentët)

Shpërblimi/ Trajnimi	Data /Periudha	Përshkrim i shkurtër

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES DHE SHKENCOR

A. Autori i parë, autori korrespondent, bashkë-autor dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare në frymën e nenit 171, 172 dhe 173 të Statutit të UHZ-së.

Në përputhje me Statutin e UHZ-së, punimi i publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohet për nevoja të emërimit, riemërimit dhe avancimit nga autori i parë i punimit, autori korrespondent dhe nga bashkautorët.

Vetëm një punim mund të zëvendësohet me tre proceeding të publikuar në Scopus ose Web of Science.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore vlejné përkufizimet vijuese:

- a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;
- b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;
- c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autor dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.
- d) Për publikime/botime të përbashkëta, apo me shumë autorë, autori kryesor dhe korrespondent marrin 100% nga pikët që ndahen; në rastin e më shumë se dy autorëve, autori i tretë, i katërt ose të tjerët kanë të drejtë të marrin deri në 50% të pikëve që ndahen në kategoritë e përcaktuara në tabelën vijuese (II.1, II.2, II.3, II.4, II.5, II.6 dhe II.7)
- e) Cilësohen si konferenca ndërkombëtare të gjitha ato konferenca kur kanë së paku 50% personel ndërkombëtar në këshillin apo bordin organizativ, dhe atë pavarësisht vendit ku mbahen.
- f) Minimumi i domosdoshëm i publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë ose korrespondent (siç kërkohet në nenet 5, 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje) llogaritet nga punimet e kategorisë A2 të kësaj Shtojce.

A.2. Bazuar në statutin e UHZ-së dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, vlejné punimet e publikuara në fushën e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në baza akademike vijuese, baras-vlerësohen me 1:

1. Web of Sciece (<http://mjl.clarivate.com>)
2. Scopus (Elsevier) (<https://www.scopus.com>)
3. EBSCOhost (<https://www.ebscohost.com/academic>)
4. WorldCat (<http://www.worldcat.org>)
5. Directory of Open Access Journals (<http://www.doaj.org>)

A.2.2. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese, baras-vlerësohen me 0.85:

1. *EconPapers* (<https://econpapers.repec.org/>)

Në proces (përcaktohen revista shtesë nga Senati)

A.2.3. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese, baras-vlerësohen me 0.70:

Në proces (përcaktohen data-baza shtesë nga Këshillat e Fakulteteve)

A.2.4. Punimet e publikuara në revistat vijuese janë të barasvlershme me 0.55:

1. *International Journal on Responsibility* (<https://commons.lib.jmu.edu/ijr/>)³

Në proces (përcaktohen Revista shtesë nga Departamentet)

A.3. Punimet e publikuara në revistat e indeksuara në platformat e përfshira në pikën 3, 4 dhe 5 të nën-paragrafi A.2.1 dhe në paragrafin A.2.2, A.2.3 si dhe revistat në paragrafin A.2.4, nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të kandidatëve nëse në momentin e publikimit revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave dhe botuesve të dyshimtë.

Tabela II.1. Publikimet në revista ndërkombëtare që plotësojnë kushtet si në paragrafët A1 deri A4

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët

Vërejtje: Për thirrjen Prof. i rregullt, kandidati duhet t'i ketë së paku 5 punime, për thirrjen Prof. i asocuar së paku 3 punime, për thirrjen Prof. asistent së paku 1 punim nga kjo kategori.

B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk janë përfshirë në Tabelën II. 1. të kësaj shtojce (në cilësinë e autorit të parë, autorit korrespondent ose bashkautorit)

Tabela II.2. Publikimet në revista akademike ose shkencore vendore

(Varësisht se në cilën revistë është i publikuar punimi, vlerësimi bazohet në pikët sipas paragrafëve A2.)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët

³ Nëse kjo Revistë indeksohet në të ardhmen në platformat e cekura në A.2.1-A.2.3), poentomi bëhet konform pikëve të platformave.

C. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve në lëmin e kandidatit (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.3 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj., në gjuhë të huaja (baras-vlerësohet me 0,50 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim), Titulli i Punimit, Shtëpia Botuese, Vendi, Viti	Lloji i punimit & Vegëza identifikuese (nëse ka)	Pikët

Tabela II.4. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj., në gjuhën shqipe (baras-vlerësohet me 0,20 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Lloji i punimit & Vegëza identifikuese (nëse ka)	Pikët

D. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminare, workshopet (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.5. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminare, workshopet në nivel ndërkombëtar, (baras-vlerësohet me 0.35 pikë nëse janë publikuar në platformat e paragrafit A.2.1 të kësaj shtojce; 0.20 pikë në platformat e paragrafit A2.2 të kësaj shtojce dhe 0.1 pikë në platformat dhe revistën e paragrafëve A2.3 dhe A2.4 të kësaj shtojce)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët

Tabela II.6. Publikimet nga kongrese, konferencat, simpoziumet, seminare, workshopet vendore, (baras-vlerësohen me 0.05 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët

E. Aktiviteti tjetër kërkimor shkencor-shkencor (baras-vlerësohet me 0.05 pikë)

Tabela II.7. Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar), nga lëmi i kandidatit.

Nr.	Autorët (renditja si në ligjeratë/prezantim) & Titulli i ligjëratës/prezantimit, vendi, viti	Lloji i ligjëratës: konferencë, simpozium, punëtori, universitet, etj.	Pikët

Tabela II.8. Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore

Nr.	Kontributi (Redaktor/Recensent/Anëtar Bordi Shkencor)	Autori origjinal i punimit (nëse është rasti)	Titulli i punimit të recensuar	Revista/ Konferenca	Vendi, Viti

Tabela II.9. Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i publikimit, shtëpia botuese, viti dhe vendi)	Lloji & Vegëza identifikuese nëse ka

F. Kontributi në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme**Tabela II.10. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme**

Nr.	Titulli i programit/projektit shkencor	Institucioni, Vendi dhe Viti	Pozita/Kontributi në program ose projekt

G. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar**Tabela II.11. Patentet zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar**

Nr.	Autorët (renditja si në patentën e zyrtarizuar)	Titulli i patentës	Institucioni, vendi, dhe viti i zyrtarizimit

Shtojca III**FORMULAR PËR AKTIVITETIN SHËRBYES**

- Ky formula përfshinë aktivitetin në shërbim të njësisë akademike, Universitetit dhe disiplinës apo profesionit, dhe ka si qëllim të vlerësojë aktivitetin në lidhje me zhvillimin profesional dhe kontributin në jetën institucionale dhe menaxhimin e institucionit apo të departamentit përmes pjesëmarrjes në komitete akademike dhe administrative, si dhe ushtrimin e përgjegjësisë të tjera institucionale në kuadër të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

- A. Shërbimi në lidhje me Fakultetin dhe Universitetin (baras-vlerësohen me 0.01 pikë)



Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrimi i aktivitetit të shërbimit dhe rezultatet	Pikët

B. Shërbimi në lidhje me disiplinën/profesionin tjetër (komisionet e ndryshme vlerësuese dhe të pranimit në kuadër të Fakultetit) (baras-vlerësohen me 0.01 pikë)

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrimi i aktivitetit të shërbimit dhe rezultatet	Pikët

SHTOJCA PËR AKTIVITETIN ARTISTIK

Për emërimin e mësimdhënësve në thirrje akademike, në lëndët artistike, relevant është aktiviteti artistik i cili bazohet në veprimtarinë artistike e cila verifikohet duke u bazuar në dokumentacionin lidhur me aktivitetet artistike në fushën përkatëse.

Kandidatët të cilët aplikojnë për marrjen e thirrjes së caktuar mësimore në lëndët artistike, varësisht nga thirrja për të cilën aplikojnë, duhet të dëshmojnë aktivitetin artistik si në vijim:

Profesori i rregullt (paragrafi 1.2 Neni 5 i kësaj rregulloreje)

Për këtë thirrje kandidati duhet ti ketë grumbulluar së paku 5 pikë nga veprimtaria artistike në pikat a dhe b:

- së paku 5 veprimtari artistike të nivelit ndërkombëtar të prezantuara në institucione të dëshmuara kulturore/artistike,
- të ketë krijime, prezantime, interpretime apo punime të njohura artistike publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e artit dhe kulturës në nivel kombëtar,
- të jetë organizator (udhëheqës, anëtar jurie, pjesëmarrës) i një ngjarje artistike e cila ka për synim ngritjen artistike të artistëve nga fusha e vet,
- të ketë fituar mirënjohje ose shpërblime të rëndësishme ndërkombëtare për punë artistike ose pedagogjike.

Profesor i asocuar (paragrafi 1.2 Neni 6 i kësaj rregulloreje)

Për këtë thirrje kandidati duhet ti ketë grumbulluar së paku 3 pikë nga veprimtaria artistike në pikat a dhe b:

- së paku 3 veprimtari artistike të nivelit ndërkombëtar të prezantuara në institucione të dëshmuara kulturore/artistike,
- të ketë krijime, prezantime, interpretime apo punime të njohura artistike publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e artit dhe kulturës në nivel kombëtar,
- të jetë organizator (udhëheqës, anëtar jurie, pjesëmarrës) i një ngjarje artistike e cila ka për synim ngritjen artistike të artistëve nga fusha e vet,

d) të ketë fituar mirënjohje ose shpërblime të rëndësishme ndërkombëtare për punë artistike ose pedagogjike.

Profesor asistent (paragrafi 1.2 Neni 7 i kësaj rregulloreje)

Për këtë thirrje kandidati duhet t'i ketë grumbulluar së paku 1 pikë nga veprimtaria artistike në pikat a dhe b:

- a) së paku 1 veprimtari artistike të nivelit ndërkombëtar të prezantuar në institucione të dëshmuara kulturore/artistike,
- b) të ketë krijuar, prezantime, interpretime apo punime të njohura artistike publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e artit dhe kulturës në nivel kombëtar,
- c) të jetë organizator (udhëheqës, anëtar jurie, pjesëmarrës) i një ngjarje artistike e cila ka për synim ngritjen artistike të artistëve nga fusha e vet.

Vlerësimi i plotësimi të kriterëve lidhur me aktivitetet artistike për kandidatët të cilët aplikojnë në lëndët në lëndët artistike, bëhet nëpërmjet pikëve përkatëse.

Artet Muzikore

- 1. Veprimtaria artistike e prezantuar në publik me anë të interpretimit muzikor, kompozimit (të interpretuar apo në partiturë), pjesëmarrjeve në koncerte, interpretimeve të veprave autoriale në koncerte, botime autoriale muzikore;
- 2. Veprimtaria artistike e mësimdhënësve që lindin si vepra autoriale gjatë mësimdhënies artistike, që kanë karakter publik , qoftë si solist, anëtar i formacioneve kamertale apo si pjesë e një projekti më të madh të përbashkët (provimet publike të muzikës, shfaqje të përbashkëta në ansamblet e studentëve, drejtimi, dirigjimi dhe realizimi i ansambleve të studentëve dhe të ngjashme);
- 3. Veprimtaria artistike e realizuar në publik, në fushën e pedagogjisë dhe metodikës së artit muzikor, të cilat me vlerën e saj, plotësojnë kriteret dhe parakushtet artistike për veprimtarinë pedagogjike-artistike .

KOMPOZITOR\TEORIK-PEDAGOGJIK

LLOJI I VEPRIMTARISË / VEPRËS ARTISTIKE	në vend (pikë)	jashtë vendit (pikë)
1. Vepër vokale - instrumentale e interpretuar ose partiturë	0,7	1
2. Vepër simfonike ose koncert e interpretuar ose partiturë	0,6	0,9
3. Vepër kamertale - orkestrale e interpretuar ose partiturë	0,5	0,8
4. Vepër korale me përcjellje instrumentale e interpretuar ose partiturë	0,5	0,8
5. Vepër kamertale (kuartet , kuintet, etj.) e interpretuar ose partiturë	0,3	0,6
6. Vepër korale " a capella " e interpretuar ose partiturë	0,3	0,6

7. Vepër solo apo duo e interpretuar ose partiturë	0,1	0,3
8. Orkestrim , transkriptim ose harmonizim i interpretuar ose partiturë	0,1	0,3
9. Udhëheqës, seleksionues, anëtar jurie, anëtar bordi, pjesëmarrës i ngjarjeve dhe institucioneve artistike	max.0,3	max.0,5
10. Formësime të ndryshme artistike të fushëveprimit Artistik - muzikor (simpoziume artistike, masterklasë, punëtori, prezantime, ligjëratë në institucione relevante, muzikë aplikative, etj.)	max.0,3	max.0,5
11. Veprimtari artistike të vlerësuara me çmim, shpërblim, mirënjohje, etj.	max.0,3	max.0,5

Përformancat artistike publike duhet të dëshmohen edhe me video inçizim përpos dëshmive të tjera.

DIRIGJENT

LLOJI I VEPRIMTARISË ARTISTIKE	në vend (pikë)	jashtë vendit (pikë)
1.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i veprës vokale - instrumentale	0,7	1
2. Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i veprës simfonike	0,5	0,8
3.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i koncertit	0,5	0,8
4.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i veprës kamertale orkestrale	0,4	0,7
5.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i arieve solistike apo pjesëve më të vogla instrumentale (pikët për 1 vepër)	0,2	0,5
6.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i veprës korale (me përcjellje instrumentale) (pikët për 1 vepër)	0,2	0,4
7.Dirigjimi ose regjistrimi (inçizimi) i veprës korale (a capella)	0,1	0,3
8. Udhëheqës, seleksionues, anëtar jurie, anëtar bordi, pjesëmarrës i ngjarjeve dhe institucioneve artistike	max.0,3	max.0,5
9. Formësime të ndryshme artistike të fushëveprimit Artistik - muzikor (simpoziume artistike, masterklasë, punëtori, prezantime, ligjëratë në institucione relevante, etj.)	max.0,3	max.0,5
11. Veprimtari artistike të vlerësuara me çmim, shpërblim, mirënjohje, etj.	max.0,3	max.0,5

Përformancat artistike publike duhet të dëshmohen edhe me video inçizim përpos dëshmive të tjera.

PERFORMUES-INSTRUMENTIST

LLOJI I VEPRIMTARISË (VEPRËS) ARTISTIKE	në vend (pikë)	jashtë vendit (pikë)
1.Recital - përformancë publike koncertale	0,7	1
2.Koncert me orkestër- përformancë publike koncertale	0,7	1
3.Muzikë kamertale (duo, trio, kuartet kuintet), performancë publike koncertale (një vepër)	max.0,2	max.0,4
4.Interpretim i veprës solo ose duo (një vepër)	max.0,3	max.0,5
5. Koorepetitor në përformancë publike koncertale (një vepër)	0.05	0,1
6. Udhëheqës, seleksionues, anëtar jurie, anëtar bordi, pjesëmarrës i ngjarjeve dhe institucioneve artistike	max.0,3	max.0,5
7. Formësime të ndryshme artistike të fushëveprimit Artistik - muzikor (simpoziume artistike, masterklasë , punëtori, prezantime, ligjëratë në institucione relevante, etj.)	max.0,3	max.0,5
8. Veprimtari artistike të vlerësuara me çmim, shpërblim, mirënjohje, etj.	max.0,3	max.0, 5

Përformancat artistike publike duhet të dëshmohen edhe me video inçizim përpos dëshmive të tjera.

SHTOJCA PËR FORMULAR I VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE SIPAS SISTEMIT NË BAZË TË PIKËVE.

(Platformat në këtë tabelë vlejné edhe për punimet teorike të Fakultetit të Arteve)

Indeksi	Koeficienti i barasvlerësimit	Autori parë	Autor korrespondent	Bashkëautor
Revista në platforma 1-5 sipas pikës 1 të nenit 3 të UA 01/18	1 pikë	1 pikë	1 pikë	0,50
Revista në databaza sipas pikës 2 të nenit 1 të UA 01/18 (3 platforma të përcaktuara nga Senati)	0.85 pikë	0.85 pikë	0.85 pikë	0,425
Revista në databaza sipas pikës 3 të nenit 1 të UA 01/18 (platforma të përcaktuara nga Këshilli i fakultetit)	0.70 pikë	0.70 pikë	0.70 pikë	0,35
Revista në databaza sipas pikës 4 të nenit 3 të UA	0.50 pikë	0.50 pikë	0.50 pikë	0,25
Proceedings në databaza 1-5 sipas pikës 1 të nenit 3 të UA 01/18	0.35 pikë	0.35 pikë	0.35 pikë	0,175
Proceedings në databaza sipas pikës 2 të nenit 1 të UA 01/18 (3 platforma të përcaktuara nga Senati)	0.20 pikë	0.20 pikë	0.20 pikë	0,10
Proceedings në databaza sipas pikës 3 të nenit 1 të UA 01/18 (platforma të përcaktuara nga Këshilli i fakultetit)	0.10 pikë	0.10 pikë	0.10 pikë	0,05
Proceedings në databaza sipas pikës 4 të nenit 3 të UA	0.10 pikë	0.10 pikë	0.10 pikë	0,05
Pjesëmarrje në konferenca vendore dhe rajonale	0.05 pikë	0.1 pikë	0.1 pikë	N/A
Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare	0.1 pikë	0.05 pikë	0.05 pikë	N/A
Publikimi i librave në vend	0.20 pikë	0.20 pikë	0.20 pikë	0,10
Publikimi i librave jashtë vendit	0.50 pikë	0.50 pikë	0.50 pikë	0,25
Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar), nga lëmi i kandidatit	0,05 pikë	N/A	N/A	N/A
Shërbimi në lidhje me Fakultetin dhe Universitetin	0,01 pikë	N/A	N/A	N/A
Shërbimi në lidhje me disiplinën/profesionin tjetër, (komisionet e ndryshme vlerësuese dhe të pranimit në kuadër të Fakultetit)	0,01 pikë	N/A	N/A	N/A
Aktivitetet mësimore, me përqendrim të përvojave relevante	1 vit = 0,1 pikë	N/A	N/A	N/A

